

Pranuar me dt.	29.10.2021		
Niveli i Organ.	Numër	Nr. Ekzempl.	Vlerë
	138/1		

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" – MITROVICË
University "Isa Boletini" - Mitrovica
Fakulteti Juridik – Faculty of law

Këshilli i Fakultetit Juridik, në mbështetje të nenit 72 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, nenit 8 të Rregullores nr. Prot. 1670, dt. 28.09.2021 për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë, dhe nenit 22 pika 1 të Rregullores mbi zgjedhjet në Universitetin e Mitrovicës dhe punën e Këshillit të Fakultetit më datë 29.10.2021 merr këtë:

VENDIM

1. Këshilli i Fakultetit Juridik në mbledhjen e mbajtur më datë 29.10.2021 ka shqyrtuar dhe aprovuar Raportin e Komisionit Vlerësues të emëruar nga Këshilli i Fakultetit Juridik, sipas konkursit të shpallur nr. prot 1712 dt.01.10.2021 të UIBM, për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë.
2. Këshilli i Fakultetit ka pranuar dhe miratuar Raportin e Komisionit Vlerësues për këtë pozitë, sipas të cilit kandidati Enver Gërguri nuk e ka plotësuar kriterin kryesor të konkursit për angazhim në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm për lëndën "Sociologji", konform konkursit të shpallur, meqenëse diploma e tij e doktoratës nuk i takon fushës së sociologjisë, por të shkencave politike. Prandaj, Komisioni Vlerësues si të tillë e ka refuzuar kandidatin e përmendur.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankese brenda 8 ditëve në Komisionin për Ankesa të Fakultetit Juridik.

I dorëzohet:

- Palës;
- Zyrës për Çështje Akademike
- Arkivit të Fakultetit Juridik

Kryesuesi i Këshillit të Fakultetit

Prof. Asoc. Dr. Agron Beka



UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
FAKULTETI JURIDIK

Pranuar me dt. 25.10.2021			
Njësia organ.	Numër	Nr.Ekzempl.	Vleta
	130	1	

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË

RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES

Fakulteti	Juridik
Lënda/ët për të cilat është shpallur konkursi	Sociologjia
Kandidatët e paraqitur:	1. Beqir Sadikaj 2. Enver Gërguri

Komisioni vlerësues:

1. Kryetar	Prof. Asoc. Dr. Islam Qerimi
2. Anëtar	Prof. Ass. Dr. Shemsi Krasniqi
3. Anëtar	Prof. Ass. Dr. Përparim Gruda

Raporti i Komisionit vlerësues sipas Konkursit për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për vitin akademik 2021/2022, me numër 1712 të datës 1.10.2021

Shënimet për kandidatin/en për të cilin/en shkruhet raporti

Kandidati/ja 1

Emri dhe mbiemri	Enver Gërguri
Datëlindja dhe vendlindja	05.05.1969, Bardh i Madh
Grada shkencore	Dr. Sc.
Titulli akademik (nëse është rizgjedhje)	-
Viti kur është fituar titulli aktual (nëse është rizgjedhje)	-
Universiteti/fakulteti/departamenti	-

Sqarim: Kandidatet të cilët krahas gradës doktor i shkencave kanë edhe titullin akademike të ligjëruesit ose profesorit, të fituar në UP, kanë përparësi në përzgjedhje ndërsa për bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime kandidatet duhet të jete jo me i vjetër 30 vjet kur angazhohet për herë të parë.

Arsimimi i lartë	
Studimet e doktoratës-Universiteti, Fakulteti, departamenti, titulli i fituar, viti i doktorimit, (nostrifikimi nese kandidati ka doktoruar jashtë vendit)	Universiteti Ndërkombëtarë i Strugës, Strugë, Republika Veriore e Maqedonisë. Doktor i shkencave politike : tema : <i>*Kosova para dhe gjatë luftës së UÇK-së, veprimet e faktorit ndërkombëtarë, demilitarizimi i UÇK-së, formimi i forcës së sigurisë së Kosovës dhe planet për zhvillimin dhe modernizimin e kësaj force*</i> . 18.10.2019. E nostrifikuar nga MASHTRK me Ref.Nr.6/4-960, datë 11.03.2020.
Studimet master/Magjistraturë, Universiteti, Fakulteti, departamenti, titulli i fituar, viti i diplomimit, nota mesatare	Akademia e Mbrojtjes "Spiro Moisiu", Tiranë, Republika e Shqipërisë. Master profesional në fushën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes . Tema : <i>*Organizimi, Struktura dhe misioni i Forcave të Sigurisë së Kosovës. Planet për zhvillimin dhe modernizimin e tyre*</i> . E nostrifikuar në MASHT me Ref.Nr.6-3150, datë 10.12.2015.
Studimet themelore-Universiteti, Fakulteti, departamenti, titulli i fituar, viti i diplomimit, nota mesatare	Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Republika e Kosovës, Shkolla e Lartë Pedagogjike, Prishtinë. Diplomë e përgatitjes së lartë shkollore , datë 21.12.2005, (6.45).

Sqarim: Në këtë tabelë paraqitën shenimet për secilin kandidatë që i shkruhet raporti. Të shtohën tabela, varësisht nga numri i kandidatëve.

TABELAT E MËSIPËRME DUHET PLOTËSUAR PËR ÇDO KANDIDAT/E VEÇ E VEÇ

Përfundimi dhe propozimi

(Anëtarët e Komisionit vlerësues janë të obliguar që të shkruajnë një arsyetim të shkurtër për kandidatin të cili propozohet si bashkëpunëtorë i jashtëm. Ata janë të obliguar që të paraqesin në mënyrë të qartë propozimin e tyre vetëm për një kandidat për një pozitë (ose për më tepër kandidatë, nëse ashtu është kërkuar me konkurs). Komisioni vlerësues përmbledh të dhënat për kandidatët që kanë aplikuar dhe sjell konkludimin dhe propozimin e arsyetuar për kandidatin dhe titullin në të cilin propozohet (sipas kërkesave të konkursit, Statutit dhe pozitës së shpallur) për kandidatin i cili propozohet për pozitën e shpallur. Kjo pjesë e raportit është e përbashkët për të gjithë kandidatet, ndërsa 4 kapitujt paraprake shkruhen për secilin kandidat veç e veç (për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet për aplikim sipas Statutit dhe konkursit).


Komisioni vlerësues i formuar me vendimin e mbledhjes së Këshillit të Fakultetit Juridik, datë 22.10.2021, bazuar edhe në nenin 6 të Rregullores për procedurat lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini"- Mitrovicë, me nr. Protokollin 670, datë 28.09.2021, si edhe konkursit për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për vitin akademik 2021/2022, me numër 1712 të datës 1.10.2021, pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar konstaton: Kandidati, Enver Gërguri nuk e ka plotësuar kriterin kryesor të konkursit për angazhim në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm për lëndën e shpallur në konkurs "Sociologji", për të cilën ka aplikuar, meqenëse diploma e tij, e doktoratës nuk i takon fushës së Sociologjisë, por atyre të Shkencave Politike. Andaj nga konstatimi i theksuar me lartë, komisioni vlerësues në mënyrë unanime REFUZON kërkesën e kandidatit të përmendur.

Nënshkrimet origjinale nga anëtarët e Komisionit vlerësues:
[të shënohet thirrja e saktë akademike]

1. Prof. Asoc. Dr. Islam Qerimi, Kryetar



2. Prof. Ass. Dr. Shemsi Krasniqi, Anëtar



3. Prof. Ass. Dr. Përparim Gruda, Anëtar



Datë: 25/10/2021